




**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIËE BODY**

**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr.2026/0214

Duke u bazuar në nenin 105 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05, L-068, si dhe Ligjin 05/ L-002, si dhe nenin 48 dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Pejes dhe Rajonin e Deçanit" me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1" iniciuar nga Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK , më 23.06.2026, mori këtë

KONKLuzion PËR PËRMIRËSIM TË VENDIMIT

Plotësohet/përmirësohet paragrafi Vendimit me nr. të protokollit 2026/0214 i datës 22.06.2026, në përbërjen e panelit shqyrtues gjatë draftimit të këtij vendimi nga zyra ligjore është lëshuar një gabim teknik, andaj e njëjta plotësohet/permireshohet sipas përshkrimit cilën do ta pasqyrojmë në këtë konkluzion:

Paragrafi

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Pejes dhe Rajonin e Deçanit" me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1".

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Permiresohet/plotesohet

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashëgimise Kulturore ne Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit" me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1".

Ndërsa paragrafi tjetër largohet ne tërësi.

ARSYETIM

Në lidhje me përpilimin e Vendimit PSH nr.2026/0214 i datës 23.06.2026, konstatohet se gjate përpilimit te ketij vendimi është paraqitur një gabim teknik.

Ky gabim teknik përmirësohet/ plotësohet me anë të këtij konkluzioni, duke pasur parasysh se Dispozitivi I ketij vendimi është vendosur qe te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin e AK , ndersa ne arsyetim te ketij vendimi jane lëshur gabime teknike kryesisht ne faqen e fundit te ketij vendimi. Sipas pershkrimit te lartcekur paragrafi nuk ka lidhshmeri me dispozitivin e as me pjesen kryesore arsyetimit , andaj lidhur me vendimin në fjalë janë bërë ndryshimet e nevojshme sipas këtij konkluzioni.

Kryetari i Panelit Shqyrtues, pasi është njoftuar për lëshimet teknike të evidentuara në Vendimin e sipërpërmendur dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Procedurë Administrative, Ligji Nr. 05/L-031, me këtë konkluzion kryen korrigjimin e gabimit teknik në pjesën e arsyetimit të vendimit.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Klirmete Gashi Brajshori



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE ankues

1x1 AK-se

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së